

Ejani të vizitoni bibliotekën!

Të gjithë janë të mirëpritur në bibliotekë. Aty mund të lexoni revista dhe gazeta, të përdorni kompjuterë, të merrni libra hua, të merrni pjesë në ngjarje dhe të kaloni kohën. Biblioteka është e hapur për të gjithë pasi ajo zotërohet nga bashkia.

Ju mund t'i kërkonti ndihmë dhe informacione punonjësve të bibliotekës.

Biblioteka ka gjithashtu dhe internet falas me rrjet pa tel. Kjo do të thotë se brenda bibliotekës ju mund të keni qasje në internet në telefonin tuaj celular apo në kompjuter.

Biblioteka ka faqe interneti. Aty mund të gjeni informacione në lidhje me ngjarjet si dhe të gjeni libra, muzikë dhe materiale të tjera për t'u marrë hua. Pyesni punonjësit e bibliotekës për adresën e faqes së internetit.

Karta e bibliotekës ju jep mundësinë që t'i merrni materialet në shtëpi

Në bibliotekë mund të merrni hua libra, revista, gazeta, muzikë, kurse gjuhe, libra për fëmijë dhe filma. Për të marrë hua materialet, ju duhet një kartë e bibliotekës.

Për të marrë një kartë të bibliotekës, ju duhet të tregoni dokumentin e identifikimit dhe të jepni adresën tuaj në Finlandë. Ju duhet që të nënshkruani gjithashtu dhe një premtim se do t'i zbatoni rregullat. Rregullat tregojnë se sa kohë mund t'i mbani materialet e marra hua. Nëse nuk i ktheni në kohë materialet e marra hua, ju duhet që të paguani një gjobë. Për më shumë informacion, mund të pyesni punonjësit e bibliotekës. Karta e bibliotekës është personale; mos lejoni askënd tjetër që të përdorë kartën tuaj. Nëse e humbisni kartën tuaj, njoftoni menjëherë punonjësit e bibliotekës me qëllim që të shmanget përdorimi i gabuar.

Libra në gjuhën tuaj

Nëse biblioteka më afër jush nuk ka libra në gjuhën tuaj, punonjësit mund t'i porositin ata në një vend tjetër. Pyesni punonjësit, dhe ata do t'ju gjejnë librat që dëshironi.

Pyesni punonjësit e bibliotekës për shërbimet që ata ofrojnë. Ata mund t'ju ndihmojnë, p.sh. të gjeni mësim për gjuhën dhe pasionet tuaja.

Ju mund të gjeni informacione lidhur me shërbimet e bibliotekës dhe shoqërinë finlandeze në shumë gjuhë në www.infopankki.fi.